KRONIKË E ZEZË

Policia sulmohet me armë në Zveçan

27 janar 2023, 19:31

Shpërndaje në

Një patrullë policore në Banjskë-Izvor të Zveçanit është sulmuar me armë zjarri të premten, ka bërë të ditur Policia e Kosovës. Siç thuhet në njoftim, si pasojë e të shtënave nuk ka të lënduar, ndërsa janë shkaktuar dëme materiale në shamin e veturës nga ana e shoferit, që sipas Policisë, dyshohet të ketë qenë edhe cak i sulmit me armë zjarri.

Policia ka thënë se janë marrë veprimet e nevojshme hetimore dhe është konstatuar se vetura është goditur me një predhë të armës së zjarrit.

Një veturë e tipit Opel është identifikuar si e dyshuar. Ajo është gjetur e braktisur në një rrugë malore në distancë prej rreth 250 metra largësi. Në afërsi të automjetit të dyshimtë janë vërejtur edhe gjurmë të personave të dyshuar të cilët kanë ikur në drejtim të panjohur, thuhet në njoftim të Policisë.

"Automjeti i dyshuar i cili ka poseduar targa të dyshuara, të cilat dyshohet se nuk i përkasin të njëjtit automjet, është konfiskuar nga Policia e Kosovës për të vazhduar me procedurat e mëtejme hetimore dhe të ekzaminimit", bëhet e ditur në komunikatën e Policisë.

Pas ngjarjes, rasti është iniciuar si vrasje në tentativë dhe sulm ndaj personit zyrtar.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#POLICIA E KOSOVËS #SULM ME ARMË #ZVEÇAN

Serbi kapet me 107 kg marihuanë në Kosovë
Ushtroi dhunë ndaj gruas dhe sulmoi vjehrrin e tij, arrestohet një person në Ferizaj
300 policë nën hetim nga prokuroria në Shqipëri
Aksident në Kamenicë, pesë të lënduar
Vdiq gruaja që u godit nga vetura në Fushë-Kosovë disa ditë më parë
Zhduket një 11-vjeçar në Fushë-Kosovë
Një i lënduar nga aksidenti në rrugën Mitrovicë - Prishtinë

YouTube
Privacy
Taboola Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megazbritje.al | Sponsored

Credit Cards With Fast Approval For Bad Credit May Surprise You
Credit Cards | Search Ads | Sponsored

Arrestohet burri që dyshohet se vazhdimisht ngacmoi të miturën
Policia e Kosovës ka arrestuar një të dyshuar kosovar, pasi një e mitur ka raportuar se ai vazhdimisht e ka ngacmuar seksualisht. Rasti ka ndodhur në Gjakovë dhe po trajtohet si ...
Kohanet

Albania:The Cost Of Solar Panels May Surprise You(See Prices)
Best Solar Panel System | Sponsored

TË TJERA

Vdiq i dyshuari për plagosjen e dyfishtë në Fushë-Kosovë

Ferizajasit i merret patentë shoferi për gjashtë muaj, vozitti dyfish më shumë sesa është e lejuar

Dy të plagosurat në Fushë-Kosovë: Lëndime serioze, por jashtë rrezikut për jetë

Dy gra plagosen nga një burrë në Fushë-Kosovë

KOHA
Marketing Politika e privatësisë Kushtet e përdorimit +383 (0) 38 249 105 info@koha.net
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Partnerët: Shkabaj
Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardëso mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.